

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Diana Sina, me procesmbajtësen Lamije Kuqi, – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. Xh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.581/2014, të datës 15.09.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë **10.03.2017**, në prezencën e Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj, dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F.XH.**, nga i ati R. dhe e ëma L. e gjinisë M., i lindur me... në fsh.M. K. Malishevë, e tani me banim në Gjakovë, ka të kryer shkollën fillore, i shkorurizuar -atë i 1 fëmije, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, me numër të lejes së njoftimit....

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: Me datë të pavërtetuar e gjerë me datë 21.01.2014, në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim që vetit ti sjell përfitimi pasurore të kundërligjshme në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që nga njehsori elektrik me nr. 8190762, pasi më parë ka qenë i ç' kyçur me bllokadë, i njëjti e ka dëmtuar bllokadën me nr.07660 dhe ka bërë rikyqjen në rrjetin elektrik, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS-Distrikti në Gjakovë, me rastin e kryerjes së kontrollës me dt.21.01.2014

-me çka ka kryer veprën penale lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73, dhe nenit 321 par 1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqindë)Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës

E dëmtuara KEDS-Divizioni i rrjetit Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.581/2014, të datës 15.09.2015, kundër të akuzuarit F. Xh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit F. Xh. ,andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari F. Xh. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë, duke premtuar se të njëjtën nuk do ta përsëris, shtoi se jam në gjendje tejet të vështir materiale, jam i pa punë, në gjendje të vështirë shëndetësore, për shkak gjendjes sime shëndetësore nuk mund të punoi, jetoi vetëm, pa asnjë të ardhur, por herë pas herë më ndihmojnë familjarët që unë të mbijetoj, prandaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurorja e Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që e njëjta mbështetet në provat dhe faktet që përmban aktakuza, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshëm pa presion, duke ditur më parë për pasojat dhe favoret e pranimin të fajësisë si dhe e vlerëson korrektësinë e tij.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tersi u vërtetua se i akuzuari F. Xh. Me datë të pavërtetuar e gjerë me datë 21.01.2014, në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim që vetit ti sjell përfitimi pasurore të kundërligjshme në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që nga njëhori elektrik me nr. 8190762, pasi më parë ka qen i ç' kyçur me bllokadë, i njëjti e ka dëmtuar bllokadën me nr.07660 dhe ka bërë rikyqien në rrjetin elektrik, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS-Distrikti në Gjakovë, me rastin e kryerjes së kontrollës me dt.21.01.2014

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPP-së të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: i gjendjes së dobët ekonomike ,është i pa punë ,është në gjendje të dobët shëndetsore i pa aftë për të punuar ,pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, sjelljet e tij të më parshme ,nuk është recedivist , për herë të parë ndeshet me ligjin, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.- (Njëqindë)Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguaj shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.591/15, me datë 10.03.2017

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.